



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

V E N D I M

**PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME “MBI
AUDITIMIN FINANCIAR”
për periudhën nga data 01.01.2018 deri në 31.08.2020.**

Nga auditimi i ushtruar në Aparatin e Prokurorisë së Përgjithshme, në bazë të programit nr.809/1, datë 01.09.2020, me objekt “Mbi Auditimin financiar”, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2018 deri në 31.08.2020, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi, nuk u konstatuan devijime materiale, trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilat japim opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Mbi auditimin financiar*”, i ushtruar në Prokurorinë e Përgjithshme, sipas Programit të Auditimit me nr.809/1, datë 01.09.2020, për periudhën nga 01.01.2018 deri në 31.08.2020.

II. Të miratoj Opinionin e auditimit, gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pamodifikuar me theksim të çështjes)

Ne audituam pasqyrat financiare të Prokurorisë së Përgjithshme (Aparati), më datë 31.12.2019 të cilat përbëhen nga Bilanci, Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Arkës, dhe Pasqyra e Lëvizjes së Kapitalit si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “*Theksimi i Çështjes*”.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), Manuali i Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar,

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pamodifikuar të auditimit me theksim të çështjes**¹.

Theksimi i çështjes:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Prokuroria e Përgjithshme, sa i takon:

- evidentimit të plotë dhe të saktë në pasqyrat financiare të vitit 2020, të llogarisë “*Toka troje terren*”, e cila është kontabilizuar në mënyrë të padrejtë në vlerën 0 lekë, me qëllim saktësimin e vlerës së këtij zëri kontabël dhe rritjen e besueshmërisë së pasqyrave financiare.

-evidentimit me evidenca kontabël të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale, konkretisht llogaria 213 “*Studime dhe kërkime*”, “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, në vlerën 783,100 lekë, me qëllim detajimin e këtij zëri për të rritur saktësinë dhe plotësinë e të dhënave.

¹ **OPINIONI I PAMODIFIKUAR me theksim të çështjes:** Një opinion i pamodifikuar me theksim çështje, jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar. Theksimi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimit të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare. (ISSAI 1706.5)

- analizimit të llogarisë 468 “*Debitore të ndryshëm*”, për të evidentuar klasifikimin e atyre debitorëve që kanë shpresë arkëtimi dhe atyre pa shpresë arkëtimi, me qëllim ndjekjen e të gjitha hapave dhe shkallëve ligjore për arkëtimin e tyre.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i Prokurorisë së Përgjithshme është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafii drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Prokurorisë së Përgjithshme me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2018-2019, mungon pasqyrimi në kontabilitet i vlerës së tokës-truall në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme, më konkretisht në formatin nr. 1 “*Pasqyra e pozicionit financiar*”, “*Aktivet afatgjata materiale*”, llogaria 213 “*Toka troje terren*” është pasqyruar në mënyrë jo të saktë, në vlerën 0 lekë, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”. Grupi i auditimit konkludoi se, referuar çmimeve të publikuara,² vlera e pasurisë së paluajtshme të llojit tokë-truall, për qytetin e Tiranës, për zonën kadastrale nr. 8150, përcaktohet me një çmim prej *66,969 lekë/m²*, nga ku për sipërfaqen prej *2409,4 m²* që ka prona në fjalë, rezulton një vlerësim prej *161,355,109 lekë*. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/a faqen 13 të Raportit të Auditimit).

² <https://geoportal.asig.gov.al/sq/dhenat>

1.1 Rekomandimi:

Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritje e grupit të punës me qëllim vlerësimin dhe saktësimin e vlerës së aktiveve afatgjata jo materiale “*Toka troje terren*”, në administrim të institucionit Prokuroria e Përgjithshme.

Nga Sektori i Financës të merren masa për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Materiale, menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga grupi i punës

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2018-2019, evidentohet mungesa e evidencave kontabël të sakta, lidhur me vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale; “*Studime dhe kërkime*”. Konkretisht për llogaritë 202 “*Studime dhe kërkime*”, në vlerën 755 000 lekë, dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, në vlerën 783 100 lekë, si pasojë e mungesës së evidencave kontabël, nuk arritëm të sigurojmë informacion mbi llojin dhe natyrën e zërave që janë përfshirë në llogaritë respektive, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, duke vendosur institucionin përpara riskut që Pasqyrat financiare të mos sigurojnë të dhëna të plota dhe të nevojshme për vendimmarrjen, lidhur me këto zëra. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/a) faqe 14 të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi:

Nga Sektori i Financës të merren masat për të saktësuar me evidenca kontabël, llojin dhe natyrën e aktiveve afatgjata jomateriale/materiale në llogaritë përkatëse 202 “*Studime dhe kërkime*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të tyre.

Në vijim, Sektori i Financës të marr masa për të kryer llogaritjet e amortizimit të këtyre aktiveve, me qëllim saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2018-2019, mungon analiza e llog. 468 “*debitore të ndryshëm*” në vlerën 3,803,861 lekë. Konkretisht, në formatin nr. 1 “*Pasqyra e pozicionit financiar*”, llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” pasqyrohet në vlerën 3,803,861 lekë, vlerë e cila nuk rezulton të jetë marrë në analizë për të evidentuar klasifikimin e atyre që kanë shpresë arkëtimi dhe atyre debitorëve pa shpresë arkëtimi, në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”.

(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/a faqen 19 të Raportit të Auditimit).

3.1 Rekomandimi:

Nga Sektori i Financës të merren masat për të analizuar llog. 468 “*Debitore të ndryshëm*” në vlerën në vlerën 3,803,861 lekë , për te evidentuar klasifikimin e atyre që kanë shpresë arkëtimi dhe atyre debitorëve pa shpresë arkëtimi, duke ndjekur të gjitha hapat dhe shkallët ligjore për arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2018 nuk janë finalizuar procedurat e inventarizimit, duke mos u pasuar më tej nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit, për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër, në kundërshtim kjo me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, sa më sipër e përfunduar vetëm në vitin 2020. Nga ana e komisionit të ngarkuar me kryerjen e inventarizimit fizik, janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit, konkretisht, për vitin 2018 numri i këtyre artikujve të dëmtuar është 88 dhe vlera monetare e tyre është 7,365,350.88 lekë, për të cilat nuk është marrë asnjë masë e mëtejshme sikundër udhëzon kuadri ligjor në fuqi. Rezultoi se, nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit, mbi informacionet/relacionet e grupeve të inventarizimit, duke mos u finalizuar procesi si dhe duke rrezikuar që të mos merret siguri për vlerën e këtij zëri, sikundër pasqyrohet në Pasqyrat financiare.*(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/a faqen 28 të Raportit të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi:

Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, të ndjekin hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit për procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; proces verbalin e vlerësimit; listën e aktiveve të identifikuar për vlerësim; kriterin për vlerësimin e aktiveve; relacionin e vlerësimit; dhënien në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve; procesverbalin për dhënien në përdorim/ tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në llogarinë ekonomike 105 “Grantet e brendshme kapitale” të formatit 4 të pasqyrave financiare, është paraqitur vlera 84,674,131 lekë, që është përdorur nga institucioni për shpenzimet e aktiveve afatgjata materiale (llog.231). Në të dhënat e tabelës së akt rakordimit të shpenzimeve me thesarin, për 12 mujorin e viti 2018, paraqitet vlera 80,836,378 lekë dhe në (llog.1059) “Grante të brendshme kapitale në natyrë” jepet vlera 4,349,161 lekë nga ku totali për të dyja llogaritë rezulton 85,185,539 lekë. Kjo vlerë nuk rakordon me vlerën e granteve të brendshme kapitale, me të cilën krijon një diferencë prej 511,408 lekë, e mbartur kjo edhe në pasqyrat financiare të vitin 2020. *.(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/d faqen 48 të Raportit të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi:

Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse për sistemimin dhe saktësimin e vlerës në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse për vitin 2020.

Në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, pyetësi dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, është i miratuar nga MFE dhe përbëhet nga 19 pika. Në informacionin shpjegues për pasqyrat financiare të viteve 2018 dhe 2019, evidentohen mangësi në plotësimin e tyre si në vendosjen e përgjigjeve respektive “po” ose “jo”, ashtu edhe në zbërthimin me analizë të llogarive përkatëse, në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/e faqen 49 të Raportit të Auditimit).

6.1 Rekomandimi:

Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pyetësi dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ky seksion të plotësohet me të dhëna të sakta për elementë të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

Në vijimësi

7. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Prokuroria e Përgjithshme ka hartuar si dhe miratuar nga PP, Rregulloren e brendshme të institucionit me urdhrin nr. 235 datë 02.11.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme”, nga ku rezultoi se nuk janë reflektuar ndryshimet të cilat kanë ardhur si rezultat i ndryshimit të organikës me urdhrin nr. 29, datë 03.02.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për disa ndryshime ne urdhrin Nr. 22, datë 07.02.2019 “Mbi Strukturën dhe Organikën e PP”. Mos reflektimi i tyre mbart paqartësi në përshkrimet e punës, trajtimin dhe detyrave, përgjegjësive të secilit pozicion pune për secilën drejtori apo sektor, si edhe kriteret mbi të cilat vlerësohet puna e gjithsecilit. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/b faqe 36-37 të Raportit të Auditimit).

7.1 Rekomandimi:

Prokuroria e Përgjithshme në kuadër të ndryshime të strukturës të miratuar me urdhrin e sipërpërmendur të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, të marrë masa për hartimin e përshkrimeve të punës, trajtimin e detyrave dhe përgjegjësive të secilit pozicion pune për secilën drejtori apo sektor, konkretisht: Zëvendës Prokuror i Përgjithshëm, Drejtorja e Koordinimit Institucional së bashku me Sektorin e Koordinimit dhe Studimeve, Sektorin e Dekriminalizimit,

Sektorin e Monitorimit si dhe për Drejtorinë Gjyqësore, për të cilën janë shtuar disa pozicione te reja pune.

Brenda datës 31.03.2021

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

K R Y E T A R

Arben SHEHU